



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 30 të Rregullorës (QRK) nr. 04/2016 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimi, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIM

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni Komunal për Riintegrim, (në vazhdim të tekstit KKR) në përbërje si vijon:

1. Avdullah Fazliu, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Sevdije Vishesella, Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
4. Sahit Zeqiri, Qendra për Punë Sociale, anëtar
5. Ismet Gashi, Enti për Punësim, anëtar
6. Flakadon Banushi, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtar
7. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
8. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
9. Mimoza Karameta, Zyrtare për Intgrime Evropiane, anëtare
10. Radmila Simijonoviq, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që të merr Vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emrgjente si:

- banim përmes qirasë,
- asistencë sociale,
- pako e ndihmës për dimër,
- trajtim mjekësor dhe pako të orendive.

KKR vlerëson mbështetjen e personave të riatdhesuar duke përfshirë qasjen në gjendjen civile, paisjen me dokumente personale, regjistrimin në shkollë, trajtim psiko-social në rast nevojë, ndihmë sociale, banimi, punësimi dhe rregullimin e dokumenteve kadastrale.

Neni 3
Punët teknike dhe administrative

Punët e pranimi të kërkesave, mbajtjen e procesverbaleve të Komisionit, përgatitjen e Vendimeve dhe punët tjera administrative-juridike për Komisionin do t'i kryej Zyra Lokale për Komunitete.

Neni 4
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit, Ministria e Punëve të Brendshme-Zyra për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikohet në Webfaqen e Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi për Themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrimin e personave të riatdhesuar 1Nr.031-7603 i datës 18.06.2012, Vendimi për plotësimin e Vendimit për Themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrimin e personave të riatdhesuar 1Nr.031-7603/2 i datës 02.07.2012 si dhe Vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit 1Nr.112-37601 i datës 16.09.2014.

1Nr. 011-27033

Lipjan, më 23.05.2016

